

Përmbajtje

1. Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredihënës nga Banka e Kursimeve.....1 Miratuar me vendimin nr. 26, datë 14. 04. 2004 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.	1
2. Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank.....2 Miratuar me vendimin nr., datë 14. 04. 2004 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.	2
3. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004.....3	3
4. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004.....3	3
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004.....3	3
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004.....4	4
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004.....4	4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr. 26, datë 14. 04. 2004

Për

lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të nenit 26 të ligjit nr.8365 , datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të lejojë Bankën e Kursimeve të kryejë aktivitetin kredidhënës sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë, pas hyrjes në fuqi të kontratës së shitjes 100 për qind të aksioneve të saj të nënshkruar nga Ministria e Financave dhe Raiffeisen Zentralbank Osterreich Aktiengesellschaft.
2. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit nr.74, datë 05.09.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli MEMISHA

KRYETARI
Shkëlqim CANI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 27, datë 14. 04. 2004

Për

Miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" ,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin për transferimin e pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank Osterreich Aktiengesellschaft.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
Ylli MEMISHA**

**KRYETARI
Shkëlqim CANI**

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004. Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004. Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS” .
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004. Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SWIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004. Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004. Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë” .

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004. Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004. Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr. 10, datë 25.02.2004. Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004. "Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004. Për "Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004. Për "Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare".
2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004. "Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004

1. Vendim nr. 20, datë 24.03.2004. Për miratimin e rregullores "Mbi kredinë brenda ditës".
2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004. "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës" miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".
3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004. Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".
4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004. Për "Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë".